



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, ASETIVE DHE
SHËRBIMEVE

Nr. 786 prot.

Tiranë, më 3. 2 2021

Lënda: Lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe në nenet 32, 33 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Ekspertizës i MASR-së në mbledhjen e datës ____ . ____ 2021, shqyrtoi dhe miratoi listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve.

Miratohet

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ALQI KUSHI



Nr.	Artikulli përshkrues	Afati i ruajtjes	Vërejtje
I	Ministër Dokumente me homologët, personalitete në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë, letra falenderimi, urime, mesazhe, dokumente për mbështetje financiare në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë etj. A) Letra, kërkesa për mbështetje financiare në rastet e gjendjeve të fatkeqësive natyrore, gjendjeve të jashtëzakonshme, pandemisë globale, etj. B) Letra falenderimi, urime, mesazhe, etj.	RHK 10 vjet	
II	Kabineti Dokumente me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, dokumente për vizitat jashtë vendit të ministrit, etj.		

	<p>A) Informacione drejtuar Kuvendit në lidhje me interpelancat, informacione drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Presidentit mbi çështjet në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë, informacione rreth vizitave të ministrit jashtë vendit.</p> <p>B) Miratime të vizitave jashtë vendit, evidenca, informacione periodike të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë, etj.</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
<p>III</p>	<p>Zëvendësministër</p> <p>Dokumente sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse të secilit zëvendësministër, parauniversitar, arsimit të lartë publik dhe jopublik, sportit dhe rinisë.</p> <p>A) Urdhra, vendime, procesverbale, strategji, etj.</p> <p>B) Evidenca, informacione periodike të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë, etj.</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
<p>IV</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p> <p>Dokumente për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e MASR.</p> <p>A) Rregullore, urdhra, plani dhe analiza vjetore, informacione mbi prioritetet dhe veprimtarinë e insitucionit,etj</p> <p>B) Evidenca, informacione periodike të përfshira në përmbledhëse , korrespondencë e thjeshtë,etj</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
<p>V</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit,Sportit dhe Rinisë</p> <p>Dokumentat per ciklin e parë, dytë dhe tretë të studimeve, doktoraturat, specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, fondi i ekselencës,dokumente për studentët e ardhur nga trojet (Kosovë,Mali i Zi,Maqedoni, Serbi), dokumente për sistemin part-time, dokumente me QSHA-në për numrat e matrikullimit të studentëve,kuotat,verifikimet e kuotave,dokumente të KVTA-së për regjistrimin e titujve shkencorë (Profesor, Asistent Profesor,Doktor), korrespondencë me ASCAL lidhur me institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë,dokumente për njohjen e diplomave të fituara jashtë RSH,për autenticitetin e diplomave të përfunduara brenda vendit,dokumente mbi përgatitjen dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të arsimit parashkollor,fillor dhe të mesëm,dokumente mbi përgatitjen e bazës ligjore dhe monitorimi i zbatimit të dokumentacionit të Maturës Shtetërore,përgatitja e bazës ligjore për provimet e lirimit në përfundim të arsimit 9-vjeçar, dokumente mbi projekte dhe bashkëpunim me OJF-të për çështjen e mësimdhënies të fëmijëve romë,</p>		

	<p>dokumente mbi përgatitjen dhe monitorimin e olimpiadave në nivel kombëtar në lëndët shkencore në arsimin parauniversitar,dokumente mbi programet e arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional 3+2,dokumente mbi arsimin social- kulturor,gjimnazet gjuhësore,shkollat artistike, shkollat sportive,projekti e-Learning në shkollat e mesme,dokumente për sportin shkollor dhe universitar.</p> <p>A) Ligje, vendime, urdhra, udhëzime, relacione, akt-marrëveshje, procesverbale,plane dhe programe mësimore, raporte, studime,etj.</p> <p>B) Evidenca, informacione periodike të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë,etj</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
<p>VI</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse</p> <p>Dokumente mbi çështjet gjyqësore,shpronësimet dhe privatizimet e objekteve të ndryshme arsimore, dokumente mbi çdo urdhër prokurimi lidhur me tenderat e buxhetit të shtetit,dokumente me APP-në dhe KPP-në,dokumente mbi regjistrin e prokurimit publik, dokumente mbi emërimet e personelit të ministrisë, bashkëpunimi me DAP, të institucioneve të varësisë, dokumente me ILDKPI mbi deklaratat e pasurisë për MASR dhe institucionet e varësisë, dokumente mbi dekorimet në arsim dhe korrespondenca me institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë,dokumente mbi numrin e punonjësve të institucioneve të varësisë dhe i sistemit arsimor parauniversitar,statistika vjetore,struktura dhe organika e MASR dhe e institucioneve të varësisë,dokumente mbi programet, raportet e kontrollit të auditit në institucionet e varësisë, bilancet vjetore, dokumente për dhënie bursa ekonomike, dokumente me FZHR mbi miratime fondesh për investime, dokumente mbi buxhetin për investimet në arsim,për fondet e shkencës, për shkollat e larta publike, për subvencionet e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve, subvencioni i teksteve shkollore, etj.</p> <p>A) Vendime,urdhra, udhëzime,relacione, urdhra prokurimi ,kontrata, dhënie titujsh,statistika vjetore, struktura dhe organika, programe kontrolli, raporte auditimi, studime,bilanci, buxheti, vendimet e FZHR,etj.</p> <p>B) Evidenca dhe informacione periodike të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë,etj.</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
<p>VII</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme Regullatore dhe e Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë</p> <p>Dokumente mbi regjistrimin e modeleve të formave të diplomave të arsimit të lartë publik dhe jopublik, platforma kontrolli në institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë për zbatimin e ligjshmërisë,</p>		

<p>dokumente mbi miratimin e statuteve të shkollave të larta publike dhe jopublike, procesi zgjedhor në institucionet e arsimit të lartë, dokumente mbi bashkëpunimin në fushën e arsimit me shtete të ndryshme, dhënia e bursave universitare dhe pasuniversitare, marrëveshje dypalëshe me shtete të ndryshme në fushën e arsimit dhe sportit, dokumente mbi kurset e gjuhës shqipe për studentët e huaj, dokumente mbi projektet me universitetet e huaja në kuadër të marrëveshjeve, dokumente mbi bashkëpunimin me Këshillin e Ministrave, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strategjitë me ministritë e linjës, dokumente të korrespondencës me Qendrën Kombëtare të Biznesit, etj.</p> <p>A) Ligje, urdhra, vendime, udhëzime, platforma kontrolli, statute, marrëveshje, projekte, raporte, memorandume, miratime dhënie liçence, etj.</p> <p>B) Evidenca dhe informacione periodike, korrespondencë e thjeshtë me shtete të ndryshme, fletë-thirrje, vendime gjyqate, etj.</p>	<p>RHK</p> <p>10 vjet</p>	
--	---------------------------	--